



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK FIER  
KRYESIA

Nr. 6689 Prot

Fier, më: 25/05/2026

LËNDA: Procesverbali i Mbledhjes se Komisionit Ekonomise Vendore Taksave e Tarifave  
te Keshillit Bashkiak Fier.

DREJTUAR: Sekretarit te Keshillit Bashkiak Fier

I/e nderuar,

Bashkëlidhur, ju dërgojme Procesverbalin dhe Raportin e Vendimarrjes te Mbledhjes se Komisionit te  
Ekonomise Vendore Taksave e Tarifave Vendore ne daten 25/05/2026

Sekretari i Kryesise KB Fier

Kreshnik Dapi

Shtojca 1 :

Model : Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

**Data e mbledhjes së Komisionit 25.05.2026**

**Ora e hapjes së mbledhjes 11:00**

Marrin pjesë : 1. Elvira Dushi këshilltar- kryetar i komisionit  
1. Arben Aulco këshilltar – zv-kryetar i komisionit  
2. Joselindi Dajç sekretar i komisionit  
3. Agim Boro anëtar  
4. \_\_\_\_\_ anëtar

Marrin pjesë gjithashtu : Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. \_\_\_\_\_  
2. \_\_\_\_\_  
3. \_\_\_\_\_

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

1. \_\_\_\_\_  
2. \_\_\_\_\_

Kryesuesi i mbledhjes është Z/zj Elvira Dushi

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 4 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit** : \_\_\_\_\_

**Pika 6 e rendit të ditës.**

Projekt-vendim "Per miratimin e pageses se shpenzimeve te varrimit te Ndjeren hava alushi"

**Pika 10 e rendit të ditës.**

Projekt-vendim "Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKB nr.109,date 27.11.2025" Mbi strukturen,nivelin e taksave dhe tarifave vendore te Bashkis Fier per vitin 2026"

**Pika 13 e rendit të ditës.**

Projekt-vendim "Per detajimin dhe perdorimin e fondit te kushtezuar per mbrojtjen civile"

**Pika 15 e rendit të ditës.**

Projekt-vendim "Per miratimin e Pasqyrave Financiare te Konsoliduara per vitin 2025 te Bashkise Fier dhe Instucioneve vartese "

**Pika 16 e rendit të ditës.**

Projekt-vendim "Per miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore te vitit 2025 te shoqerise "Apollonia sh.a"

Drejtuksi i komisionit prezanton projekt-vendimin

*Pika 3 e Rendit te Dites - Per othenien e miratimit te ekzekutivit te Bashkise per fillimin e procedurave te paushes se objektit shkolle 3-vjeore*

Pyetje ( nga keshilltarët ) \_\_\_\_\_

Përgjigje / sqarime nga ekzekutivi \_\_\_\_\_

*dili Stane Topoje*

**Diskutime :**

Keshilltari \_\_\_\_\_ deklaroi / propozoi \_\_\_\_\_

Keshilltari *Pika nr 10* deklaroi / propozoi *Dipa korrigitme ne anegrafu dhe shprehje*

Keshilltari *Pika nr 11* deklaroi / propozoi *Dipa korrigitme anegrafike dhe shprehje te cilat ato*

Keshilltari \_\_\_\_\_ deklaroi / propozoi *te bashkojten procesverbal gjithashtu*

Keshilltari \_\_\_\_\_ deklaroi / propozoi *komisioni kerkon nga propozuesu denien*

*ne disponuesen sipas vites se 255, dt 20.4.23 vertetimet nga KA2-ja per mte e marra dhe te votave te subjektit per bashkimi e fundit per 18 mbrane.*

**Hidhen në votë** propozimet për amendim të projekt-vendimit :

Propozim 6 : Vota PRO <u>4</u>	Kundra _____	Abstenim _____	Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 10 : Vota PRO <u>4</u>	Kundra _____	Abstenim _____	Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 13 : Vota PRO <u>4</u>	Kundra _____	Abstenim _____	Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 15 : Vota PRO <u>2</u>	Kundra <u>2</u>	Abstenim _____	Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 16 : Vota PRO _____	Kundra <u>2</u>	Abstenim _____	Miratohet / Nuk miratohet

**Propozimi**

- Bashkojtor me procesverbalin po dorozojme projekt-vendimin dhe Relacabun endryshuar me korrigitmet perkatese per piken 10 te rendit te ditës
- Do dhe projekt-vendimin dhe Relacabun me korrigitmet perkatese bashkelidhor dhe dy vertetimet nga kuvendi i Shqiperise me nr. prot. 2323/1 dt 22.05.2026 dhe nga KA2 me nr prot 1249/1 dt 22.05.2026 te subjektit Partia Social Demokratike e Shqiperise per pikën 11 te rendit të ditës.

## Mbyllet diskutimi

**Përgatitet Raporti** i mbledhjes së Komisionit për çdo projekt-vendim që do t'i paraqitet këshillit në seancë. Raporti u përgatit nga Kryetari / zëvendëskryetari i Komisionit/ sekretari i Komisionit

**Lexohet Raporti** (1, 2) nga Kryetari / zëvendëskryetari (për çdo projekt-vendim)

**Votohet Raporti** (1, 2) : Votimi u bë i hapur/ fshehtë – (për çdo projekt-vendim)

U votua raporti Projekt vendim 6: PRO 4 KUNDER \_\_\_ ABSTENIM \_\_\_ - Miratohet / Nuk miratohet  
U votua raporti Projekt vendim 10: PRO 4 KUNDER \_\_\_ ABSTENIM \_\_\_ - Miratohet / Nuk miratohet  
U votua raporti Projekt vendim 13: PRO 4 KUNDER \_\_\_ ABSTENIM \_\_\_ - Miratohet / Nuk miratohet  
U votua raporti Projekt vendim 15: PRO 4 KUNDER \_\_\_ ABSTENIM \_\_\_ - Miratohet / Nuk miratohet  
U votua raporti Projekt vendim 16: PRO 4 KUNDER \_\_\_ ABSTENIM \_\_\_ - Miratohet / Nuk miratohet


## Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes 12:15

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

**Kryetari i Komisionit**

**ERLINDA TAVANXHIU**

*Erlinda Llapçi Tavankhiu*  


**Sekretari i Komisionit**

**KRESHNIK DAPI**



Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Fier  
KËSHILLI BASHKIAK  
Komisioni i Përherëshëm për Ekonomia të Vendlorë

(Adresa, \_\_\_\_\_ nr. Tel \_\_\_\_\_, e-mail \_\_\_\_\_)

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. \_\_\_\_ datë 25/05/2026

Nr. \_\_\_\_ Prot

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** **Pika:6** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.48 datë 18.05.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për Per miratimin e pageses se shpenzimeve te varrimit te se ndjeres HAVA ALUSHAJ “.

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Bazuar ne ligjin nr.139/2025 “Per veteqeverisjen vendore”,si dhe aktet ligjore e nenligjore per ndihmen sociale dhe mbeshtetjen financiare nga njesit e veteqeverisjes vendore.

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Kerkohet mbeshtetje financiare per mbulimin e shpenzimeve financiare per mbulimin e shpenzimeve te se ndjeres HAVA ALUSHAJ.

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Pagesa do te perballohet nga fondi perkates i parashikuar ne buxhetin e Bashkis Fier.

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Zbatimi dhe raportimi do te ndiqet nga Drejtoria e Finances dhe Drejtoria e Sherbimeve Sociale.

**Impakti social / grupet që preken:**

Ndikim social pozitiv per familjen perfituese dhe mbeshtetje ne situatë sociale emergjente.

**A është objekt i konsultimit publik:**

Nuk eshte objekt i konsultimit publik.

**Lenda:** **Pika 10-**Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.52 datë 18.05.2026, Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKB nr 109,date 27.11.2025''Mbi strukturen,nivelin e taksave dhe tarifave vendore te Bashkise Fier per vitin 2026.

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Bazuar ne ligjin nr.139/2025 "Per veteqeverisjen vendore",ligjin nr 9632,date 30.10.2026''Per sistemimin e taksave vendore,i ndryshuar ligjin nr.9920 date,19.05.2008Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise,i ndryshuar si dhe aktet nenligjore ne fuqi per taksat dhe tarifate vendore.

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Kerkohet miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve ne strukturen dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2026,me qellim pershtatjen me nevojat aktuale te administrimit vendor dhe permiresimin e ofrimit te sherbimeve publike.

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Ndryshimet e propozuara ndikojne ne te ardhura vendore te Bashkise Fier dhe synojne rritjen e efciences ne mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Zbatimi do te realizohet nga Drejtoria e Finances me raportim periodik prane strukturave drejtuese te Bashkise Fier.

**Impakti social / grupet që preken:**

Ndikon te subjektet dhe qytetaret perfitues apo pagues te taksave dhe tarifave vendore,duke synuar permiresimin e cilesise se sherbimeve publike dhe administrimit vendor.

**A është objekt i konsultimit publik:**

Po eshte objekt i konsultimit publik sipas legjislacionit per konsultimin publik dhe procedurave te miratimit te taksave dhe tarifave vendore.

**Lenda:** **Pika 13-**Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.93 datë 18.05.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për Per detajimin dhe perdorimin e Fondit te kushtezuar per mbrojtjen civile

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Bazuar ne ligjin nr.45/2019 Per mbrojtjen civile,ligjin nr.139/2015 Per veteqeverisjen vendore”,si dhe legjislacionin per menaxhimin e sistemit buxhetor.

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Kerkohe detajimi dhe perdorimi i fondit te kushtezuar per perballimin e situatave emergjente dhe forcimin e strukturave te mbrojtjes civile.

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Fondet jane te parashikuara ne buxhet si fond i kushtezuar dhe do te perdoren sipas destinacionit ligjor.

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Monitorimi do te kryhet nga Drrejtoria e Finances dhe strukturat e mbrojetjes civile,me raportim periodik prane Bashkise Fier.

**Impakti social / grupet që preken:**

Ndikon pozitivisht ne rritjen e sigurise dhe mbrojtjes se qytetarve ne raste emergjencash civile.

**A është objekt i konsultimit publik:**

Nuk eshte objekt i konsultimit publik.

Algent Broka Gausubor

**Lenda:** **Pika 15-**Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.47 datë 18.05.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për Per miratimin e Pasqyrave Financiare te Konsoliduara per vitin 2025 te Bashkise Fier dhe Instuticioneve vartese

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Bazuar ne ligjin nr.9936/2008 Per menaxhimin e sistemit Buxhetor,ligjin,nr.10296/2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe udhezimet e Ministrise se Financave.

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Eshte kryer konsolidimi i pasqyrave Financiare te Bashkise Fier dhe institucioneve vartese per vitin ushtrimor 2025.

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Pasqyrat Financiare paraqesin situaten ekonomike dhe financiare te Bashkise Fier dhe institucioneve vartese per vitin 2025.

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Monitorimi realizohet nga Drejtoria e Finances dhe institucioneve pergjegjese te auditimit dhe kontrollit financiar.

**Impakti social / grupet që preken:**

Rrit transparencen dhe llogaridhenien ne administrimin e fondeve publike.

**A është objekt i konsultimit publik:**

Nuk eshte objekt i konsultimit publik.

**Lenda:** Pika 16-Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.46 datë 18.05.2026, Per miratimin e Pasqyrave Financiare te vitit 2025 te shoqerise "Klubi Shumesportesh Apollonia sh.a".

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Bazuar ne legjislacionin per shoqerit Tregtare,menaxhimin financiar dhe aktet rregullatore per institucionet ne varesi te Bashkise Fier.

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Eshte kryer konsolidimi i pasqyrave Financiare te Bashkise Fier dhe institucioneve vartese per vitin ushtrimor 2025.

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Pasqyrat Financiare paraqesin gjendjen financiare dhe aktivitetin ekonomik te shoqerise per vitin ushtrimor 2025.

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Monitorimi realizohet nga organet drejtuese te shoqerise dhe Drejtoria e Finances se Bashkise Fier.

**Impakti social / grupet që preken:**

Ndikon ne rritjen e transparences financiare dhe vijimesine e aktiviteteve sportive ne qytet.

**A është objekt i konsultimit publik:**

Nuk eshte objekt i konsultimit publik.

Arta Hoxha  
Faqe 1  
Arben Cukaj  
Albert Braka

Komisioni i Përhershëm shqyrtoi te gjitha projekt vendimet dhe relacionet e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet te paraqitura nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimeve dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

## VENDOSI



1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
  - ✓ Pika 6 e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
  - ✓ Pika 10 e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
  - ✓ Pika 13 e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
  - ✓ Pika 15 e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
  - ✓ Pika 16e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

  
Erdato Dhepi **Kryetar i Komisionit**  
(emri, mbiemri, firma)

  
Besnik Dhepi **Sekretar i Komisionit**  
(emri, mbiemri, firma)

  
Arben Çulco  
  
Algert Braker

Datë 28.05 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2026

**PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PAJISJEN ME ZYRË VENDORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË.**

Në mbështetje të Nenit 9 (pika 1.3), Nenit 54 dhe Nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Nenit 22, shkronja "b" të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", të ndryshuar; përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 255, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike"; si dhe në referim të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Fier, me propozim të Grupit të Këshilltareve Bashkiak, Këshilli Bashkiak:

**PROPOZON:**


1. Miratimin në parim të kërkesës nr. 2327 prot., datë 05/05/2026, të paraqitur nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, për pajisjen me një ndërtesë për zyrë vendore në territorin e Bashkisë Fier.
2. Ngarkimin e administratës së Bashkisë Fier që, brenda një afati prej 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kryejë verifikimin e plotë të aseteve dhe të identifikojë një ambient të lirë e të përshtatshëm nga fondi i pasurive të paluajtshme të bashkisë, me sipërfaqe jo më shumë se 50 m<sup>2</sup>.
3. Në rast të pamundësisë objektive për sigurimin e një ambienti nga fondi i aseteve të lira të bashkisë, ngarkohet Kryetari i Bashkisë të njoftojë zyrtarisht subjektin kërkues për ushtrimin e të drejtës së marrjes së ambientit me qira nga të tretët (pronarë privatë), duke marrë përsipër

mbulimin e kostos së qirasë nga buxheti i shtetit / fondet përkatëse, brenda kufijve maksimale ligjorë në fuqi (750 lekë/m<sup>2</sup> për zyra pa pajisje dhe 1,000 lekë/m<sup>2</sup> për zyra me pajisje).  
4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier.

## PROPOZUESI

### GRUPI i KESHILLTAREVE

**Arben Çuko**



**Melsi Bogdani**



**Fatbardha Merkaj**



**Marjus Voja**



**Kreshnik Dapi**



**Endri Jaupaj**



**Rrapi Gjika**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT- VENDIM

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 109, datë 27.11.2025 "Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026 "**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", gërma "f" e ndryshuar, të nenit 54; Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin nr.9920, datë19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa, bazën e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar me VKM nr. 144, datë 13.02.2020; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; ndryshuar; Rregullores së Këshillit Bashkiak Fier Neni 91,92,93; Dëgjuesën publike të zhvilluar më datë 02/04/2026 dhe procesverbalin e dëgjuesës publike nr. \_\_\_\_\_ prot, Keshilli Bashkiak:

#### PROPOZON :

Në VKBnr.109,datë27.11.2025 "Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026 ", të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

**1. Në tabelën nr. 5 "Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe zonave", pika 2 gërmat "b", "c" dhe "d" ndryshohen si më poshtë :**

<b>Objekte për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të kryera nga shoqëri ndërtimi - llogaritet me çmimin e shitjes për m<sup>2</sup> x %</b>				
<b>a) Objekt njëkatësh</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>
<b>b) Objekte 2-3 kate</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>
<b>c) Objekte mbi 4 kate</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>
<b>d) Objekte për qëllime shërbimi</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkise.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**PROPOZUESI**

**GRUPI I KESHILLTAREVE**

**Arben Çuko**



**Melsi Bogdani**



**Fatbardha Merkaj**



**Marjus Voja**



**Kreshnik Dapi**



**Endri Jaupaj**



**Rrapi Gjika**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA FIER KËSHILLI BASHKIAK

### RELACION

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2026

#### **Relacion mbi projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKB-në nr.109, datë 27.11.2025, "Mbi strukturën nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026"**

**Baza Ligjore:** Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligji nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligji 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligji nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i ndryshuar", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme'ndërtesa, bazën e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar, Rregulloren e Këshillit Bashkiak Fier, si dhe në Procesverbalin e Dëgjësës publike datë 02.04.2026 paraqet relacionin për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.109, datë 27.11.2025 " Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026", si më poshtë vijon :

Në mungesë të ndërtimeve dhe investimeve në objekte shumëkatëshe (pallate, qendra tregtare etj.), në vitet e fundit në territorin e Bashkisë Fier, për adresimin e problematikave dhe vështirësive të hasura që kanë sjellë si pasojë këtë mungesë investimesh, është mbajtur në ambientet e Bashkisë Fier një dëgjësë publike në datën 02.04.2026, me pjesëmarrjen e investitorëve të ndryshëm si palë të interesuara.

Problematikat kryesore të adresuara nga ana e investitorëve pjesëmarrës lidhen me vlerat e larta të taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhen të paguhen për tu pajisur me leje përkatëse për ndërtimin e objekteve shumëkatëshe.

Në mënyrë që të jepet zgjidhje këtij ngërçi si dhe për të krijuar mundësinë e përthithjes së investitorëve të rinj si dhe atyre aktual për të investuar në territorin e Bashkisë Fier, duke synuar zhvillim ekonomik dhe social, bëhet i nevojshëm rishikimi vlerës së përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë brenda kufijve ligjorë të përcaktuar në Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Ky rishikim i vlerave të përlogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk duhet të shikohet si ulje e vlerave të arkëtuara në buxhetin e Bashkisë Fier por si një nevojë dhe mundësi që në vazhdimësi do të kontribuojë në arkëtimin e më shumë të ardhura si pasojë e rritjes së investimeve dhe po kështu edhe si kontribut në zhvillimin dhe mirëqënien sociale ekonomike të komunitetit në përgjithësi.

Ndryshimet e propozuara konsistojnë në uljen e shkallës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllimi banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi të cilat kryhen nga shoqëritë e ndërtimit.

Përsa i përket kërkesës për ndryshimin e bazës së përlogaritjes ( nga çmim i shitjes në vlerën e investimit) niveli i taksës për ndërtimin me qëllim banimi apo shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit në vlerat midis 1% deri në 3% të vlerës së investimit, referuar ligjit të sipërcituar, ky nivel takse zbatohet për rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuar në pikën 2 të nenit 27 të ligjit, prandaj kjo pjesë ngelet e pandryshuar.

Bazuar në pikën 2 të nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përcaktohet se shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këto kategori ndërtimi është në masën 4 % deri në 8% të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

Aktualisht, me VKB nr.109, datë 27.11.2025 "Mbi strukturën nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026", vlerat e miratuara e taksës së ndikimit në infrastukturë janë përkatësisht sipas tabelës nr.5, si më poshtë:

<b>Objekte për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të kryera nga shoqëri ndërtimi - llogaritjet me çmimin e shitjes për m<sup>2</sup> x %</b>				
<b>a) Objekt njëkatësh</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>
<b>b) Objekte 2-3 kate</b>	<b>5%</b>	<b>5%</b>	<b>5%</b>	<b>5%</b>
<b>c) Objekte mbi 4 kate</b>	<b>6%</b>	<b>6%</b>	<b>6%</b>	<b>6%</b>
<b>d) Objekte për qëllime shërbimi</b>	<b>7%</b>	<b>7%</b>	<b>7%</b>	<b>7%</b>

Në përfundim të analizës së sipërcituar pas shqyrtimit të problematikave të adresuara dhe brenda kufijve ligjorë të përcaktuar në legjislacionin e posacëm në fuqi, propozohet që përlogaritja e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për Objekte për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të kryera nga shoqëri ndërtimi të bëhet/ ndryshohet sipas tabelës së mëposhtme:


Objekte për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të kryera nga shoqëri ndërtimi - llogaritet me çmimin e shitjes për m <sup>2</sup> x %				
a) Objekt njëkatësh	4%	4%	4%	4%
b) Objekte 2-3 kate	4%	4%	4%	4%
c) Objekte mbi 4 kate	4%	4%	4%	4%
d) Objekte për qëllime shërbimi	4%	4%	4%	4%

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë këtë projekt vendim në mënyrë që ti hapet rruga për përthithjes së investimeve të reja dhe zhvillimit ekonomik-social.

**PROPOZUESI**

**GRUPI I KESHILLTAREVE**


Arben Çuko



Melsi Bogdan



Fatbardha Merka



Marjush Voja



Kreshnik Dapi



Endri Jaupaj



Rrapi Gjika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER  
KËSHILLI BASHKIAK**

**RELACION**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ 2026

**PËR PROJEKTVENDIMIN "PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESËS  
PËR PAJISJEN ME ZYRË VENDORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË  
SHQIPËRISË"**

Ky projektvendim vjen si rrjedhojë e kërkesës zyrtare të protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2327 prot., datë 05/05/2026, nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë (PSD). Synimi i këtij akti është përmbushja e detyrimeve ligjore që pushteti vendor ka ndaj subjekteve politike që plotësojnë kriteret për t'u pajisur me ambiente pune (zyra vendore), me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të tyre demokratik në territorin e Bashkisë Fier.

**Baza Ligjore:**

Projektakti mbështetet plotësisht në kuadrin ligjor në fuqi:

- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar): Nenet 54 dhe 55 rregullojnë kompetencat e Këshillit Bashkiak për menaxhimin e pronave dhe miratimin e akteve.
- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" (i ndryshuar): Neni 22, shkronja "b" përcakton të drejtën e partive politike për t'u pajisur me zyra vendore, bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare (2021 dhe 2025).
- VKM nr. 255, datë 20.04.2023: Përcakton procedurën administrative të shqyrtimit, numrin e ndërtesave (1 zyrë për çdo bashki), sipërfaqen maksimale (deri në 50 m<sup>2</sup>) dhe kufijtë maksimalë të qirasë në tregun e lirë.

**Analiza e përmbajtjes dhe zgjidhjet e propozuara:**

Kërkesa e subjektit politik PSD parashikon dy faza zgjidhjeje, të cilat janë reflektuar në pikët e këtij projektvendimi:

1. Opsioni parësor: Identifikimi i një aseti të lirë dhe të përshtatshëm nga fondi ekzistues i pronave të Bashkisë Fier (Pika 2 e Vendimit). Kjo kërkon një verifikim transparent nga Drejtoria e Pronave për të shmangur deklaratimet e pasakta apo mbivendosjet.
2. Opsioni dytësor (në mungesë asetesh): Kalimi në procedurën e marrjes me qira nga të tretët (Pika 3 e Vendimit). Nëse administrata vërteton zyrtarisht se nuk disponon asnjë ambient të

lirë që plotëson kushtet teknike, subjekti njoftohet që të gjejë një ambient privat, qira e cila do të përballohet brenda tavanit ligjor prej 750 ose 1,000 lekë/m<sup>2</sup>.

**Efektet Financiare:**

Nëse Bashkia Fier vë në dispozicion një pronë nga fondi i saj i aseteve të lira, ky vendim nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e bashkisë. Në rast se do të aplikohet pika e marrjes së ambientit me qira nga të tretët, efektet financiare do të përballohen sipas zërave përkatës buxhetorë të parashikuar ne Ligj për këtë qëllim, duke mos kaluar vlerën maksimale të qirasë të normuar me VKM nr. 255 20/04/2023 për një sipërfaqe deri në 50 m<sup>2</sup>.

Nisur nga sa më sipër, ftojmë anëtarët e Këshillit Bashkiak Fier të miratojnë këtë projektvendim.

**PROPOZUESI**

**GRUPI I KESHILLTAREVE**

**Arben Çuko**



**Melsi Bogdani**



**Fatbardha Merkaj**



**Marjus Voja**



**Kreshnik Dapi**



**Endri Jaupaj**



**Rrapi Gjika**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2323/11 Prot.

Tiranë, më 22 / 05 2026

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** **Z. Altin VRIONI**  
**NËNKRYETAR**  
**PARTIA SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

I nderuar z. Vrioni,

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me nr. 2330, date 21.05.2026, për vertetim për numrin e mandateve që ka subjekti juaj politik në Kuvendin e Shqipërisë, ju informojë se:

Në bazë të Vendimit nr.34, datë 28.08.2025 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11.05.2025”, Partia Socialdemokrate, është parti parlamentare dhe ka tre deputet.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GENÇ GJONCAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Lënda: Kthim përgjigje

Tiranë më 22/05/2026

Nr. 1249/1

Drejtuar: **PARTIA SOCIALDEMOKRATE**

Rruga "Skëndërbej", Tiranë.

I nderuar z. Vrioni,

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.2139 prot, datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1249 prot. datë 21.05.2026, me lëndë "Kërkesë për vërtetim për mesataren e votave të subjektit "Partia Socialdemokrate e Shqipërisë" në tri zgjedhjet e fundit parlamentare", ju bëjmë me dije se subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë në zgjedhjet për Kuvend të vitit:

- 2017, ka marrë gjithsej 14 993 vota
- 2021, ka marrë gjithsej 35 475 vota
- 2025, ka marrë gjithsej 49 865 vota

Pra, mesatarja e votave të subjektit PSD në tri zgjedhjet e fundit për Kuvend është 33 444 vota.

Sekretar i Përgjithshëm

**Jona JOSIFI**

(në mungesë dhe me i dhër)

